



**REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT**  
**AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE**  
**PA1 Nr.08-133**  
**17.04.2025**  
**Shkup**

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 2, neni 82 paragrafi (1) nënparagrafët 5 dhe 6 dhe neni 83 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e RM-së“, nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e RMV-së“ nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24 dhe 193/24), dhe në lidhje me nenin 62 paragrafi (6) nga Ligji i njëjtë, neni 21 të Rregullores për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për dhënien e lejes për transmetim televiziv dhe radio (Tekst i pastruar) ark.nr.01-3953/1 datë 31.10.2023, neni 80 paragrafi (5) të LSHMAAV, neni 51 paragrafi (1) dhe paragrafi (3) dhe neni 52 paragrafi (2) nga Ligji i Procedurës së Përgjithshme Administrative („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“, nr.124/15), neni 28 nga Ligji i Kontesteve Administrative („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“, nr.96/19), neni 24 të Rregullores për procedurat e punës financiare dhe kontabilitetit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, ark.nr.01-6222/1 datë 12.12.2014, duke vepruar sipas Propozimit PA1 nr.08-105 datë 03.04.2025, për inicim të procedurës për heqjen dhe Propozimin PA1 nr.08-133 datë 15.04.2025 për miratimin e vendimit të heqjes së lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive KLAN MAQEDONI SHPKNJP eksport – import Saraj, Shkup, në pajtim me Konkluzionin, ark.nr.02-1752/5 datë 16.04.2025, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 17-të mbajtur më 16.04.2025 miratoi:

**VENDIM**  
**për marrjen e lejes për transmetim televiziv të**  
**Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive KLAN MAQEDONI SHPKNJP**  
**eksport – import Saraj, Shkup**

1. I HIQET leja për transmetim televiziv, PA1 nr.08-128 datë 13.03.2017 Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive KLAN MAQEDONI SHPKNJP eksport – import Saraj, Shkup, për shkak se pas dhënies së lejes ndodhën situata që paraqesin pengesa Ligjore për zotëruesin e lejes për kryerjen e veprimtarisë, përkatësisht për shkak se transmetuesi nuk i ka plotësuar kushtet minimale kadrovike të përcaktuara në Rregulloren për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për dhënien e lejes për transmetim televiziv dhe radio dhe nuk ka paguar kompensimin vjetor të lejes për transmetim televiziv në afatin e përcaktuar Ligjor – 30 ditësh nga pranimi i Faturës nr.2025-100-0086 datë 28.02.2025 (nr ynë.ark.05-830/1 datë 28.02.2025).

2. Fatura 2025-100-0086 datë 28.02.2025 (nr ynë.ark.05-830/1 datë 28.02.2025), anulohet dhe subjektit nga pika 1. Të këtij Vendimi, i jipet faturë e re, që i referohet vetëm

periudhës së punës, përkatësisht deri në ditën e marrjes së vendimit për heqjen e lejes e cila duhet të paguhet jo më vonë se 8 (tetë) ditë nga dita e dhënies së lejes.

3. Ky vendim botohet në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”, në ueb faqen e Agjencië për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele dhe në dy gazeta ditore, prej të cilave njëra është në gjuhën e bashkësisë joshumicë, por që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

4. Ky Vendim është përfundimtar.

## Arsyetim

Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (SHTR) KLAN MAQEDONI SHPKNJP eksport – import Saraj, Shkup, është zotërues i lejes për transmetim televiziv, PA1 nr.08-128 datë 13.03.2017, për transmetim nëpërmjet rrjetit publik të komunikimit elektronik që nuk shfrytëzon resurse të kufizuara, në nivel shtetëror, në teritorrin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, shërbim programor televiziv, me format të përgjithshëm kryesisht argëtues, në gjuhën maqedonase dhe shqip.

I. Në pajtim me nenin 62 paragrafi (6) të ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV) për sigurimin e transmetimeve televizive ose radio krahas kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara me këtë Ligj, transmetuesi duhet të plotësojë edhe kushte të veçanta minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike, në varësi të formatit programor, përcaktuar me aktet nënligjore të miratuara nga Agjencia.

Neni 21 të Rregullores për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për marrjen e lejes për transmetim televiziv dhe radio, parasheh se zotëruesi i lejes për transmetim televiziv të shërbimit programor me format të përgjithshëm është i detyruar në marrëdhënie të rregullt pune, të ketë së paku 20 (njëzet) persona që marrin pjesë në krijimin e programit, nëse ka leje për transmetimin e programit në nivel shtetëror përmes rrjetit publik të komunikimit elektronik që nuk shfrytëzon resurs të kufizuar, si dhe redaktori përgjegjës i shërbimit programor me format të përgjithshëm duhet të jetë në marrëdhënie të rregullt pune.

Në pajtim me nenin 27 paragrafi (1) të LSHMAAV, Agjencia kryen mbikëqyrje administrative, e cila kryhet mbi punën e botuesve të mediave nga aspekti i harmonizimit të punës së tyre me kushtet e përcaktuara me Ligjin për Media, Ligjin për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele dhe Rregulloret e miratuara në bazë të Ligjit (neni 29 paragrafi 1 të LSHMAAV).

Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia), për të kontrolluar nëse SHTR KLAN MAQEDONI SHPKNJP eksport – import Saraj, Shkup në pajtim me nenin 62 paragrafi (6) të LSHMAAV i përmbush dhe kushtet minimale kadrovike të përcaktuara me Rregulloren në fjalë, më 03.04.2025, me Shkresë, ark.nr.03-1614/1 datë 03.04.2025 kërkoi nga Agjencia për Punësim e Republikës së Maqedonisë së Veriut të dorëzoj të dhëna për numrin e të punësuarve në SHTR KLAN MMAQEDONI SHPKNJP eksport – import Saraj, Shkup. Me datë 04.04.2025 Agjencia për Punësim e RMV-së me Shkresë, ark.nr.03-1035/2 datë 04.04.2025 (nr ynë.ark.03-1614/2 datë 04.04.2025) e njoftoi Agjencinë se „sipas evidencës së Agjencisë për Punësim të Republikës së Maqedonisë së Veriut të personave të regjistruar të papunë dhe regjistrimeve / çregjistrimeve në / nga sigurimi i detyrueshëm shoqëror, për personin juridik SHTR KLAN MAQEDONI SHPKNJP eksport – import Saraj, Shkup, numri i të punësuarve në vitin 03.04.2025 është 18, dhe në vitin 31.03.2025 është 18“.

Agjencia, në lidhje me njoftimin e mësipër nga Agjencia për Punësim e RMV-së, përmes Sektorit për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit, të njëjtën ditë (04.04.2025),

ka kryer mbikëqyrje të jashtëzakonshme administrative sipas detyrës zyrtare të punës ndaj SHTR KLAN MAQEDONI SHPKNJP eksport – import Saraj, Shkup, me ç'rast në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative, nr ynë ark.03-1628/1 datë 04.04.2025, ka konstatuar se transmetuesi në fjalë nuk i plotëson kushtet minimale kadrovike të përcaktuara në Rregulloren për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për dhënien e lejes për transmetim televiziv dhe radio.

II. Në pajtim me nenin 80 paragrafi (1) të LSHMAAV, për lejen për transmetim televiziv ose radio transmetuesi, me përjashtim të shërbimit publik radiodifuziv, paguajnë kompensim vjetor në llogarinë e Agjencisë në pajtim me ligjin. Kompensimi vjetor paguhet për çdo vit aktual duke filluar nga data e dhënies së lejes për transmetim televiziv ose radio në afat prej 30 ditësh nga pranimi i faturës së dhënë nga Agjencia (neni 80 paragrafi 5 të LSHMAAV).

III. Në lidhje me kompensimin e lejes për transmetim televiziv të SHTR KLAN MAQEDONI SHPKNJP eksport – import Saraj, Shkup, PA1 nr.08-128 datë 13.03.2017, Agjencia me datë 28.02.2025 ka dërguar Faturë nr.2025-100-0086 datë 28.02.2025 (nr ynë.ark.05-830/1 datë 28.02.2025) për kompensimin e lejes, sipas së cilës transmetuesi ka pasur obligim të paguaj 3.739.549,00 (tre milion e shtatëqind e tridhjetë e nëntë mijë e pesëqind e dyzet e nëntë) denarë, për kompensim vjetor të lejes për transmetim televiziv, për periudhën nga data 28.02.2025 deri më datë 27.02.2026. Në Agjencion është dorëzuar letërkthyes (deklaratë) nga SHA Posta e Maqedonisë e RMV-së se fatura është pranuar me datë 04.03.2025.

Agjencia përmes Sektorit për financa dhe logjistikë, ka kryer mbikëqyrje administrative të punës së SHTR KLAN MAQEDONI SHPKNJP eksport – import Saraj, Shkup, nga aspekti i përmbushjes së detyrimit për pagesën e kompensimit vjetor të lejes, nga ku pas kryerjes së mbikëqyrjes së rregullt administrative, në Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative (nr ynë.ark.05-1600/1 datë 02.04.2025), konstatoi se transmetuesi në fjalë nuk ka përmbushur detyrimin ligjor të përcaktuar në nenin 80 paragrafi (5) të LSHMAAV, përkatësisht nuk ka paguar kompensimin vjetor të lejes për transmetim televiziv në llogari të Agjencisë.

Pikërisht, sipas Faturës së dorëzuar nr.2025-100-0086 datë 28.02.2025 (nr ynë.ark.05-830/1 datë 28.02.2025), SHTR KLAN MAQEDONI SHPKNJP eksport – import Saraj, Shkup, kishte për detyrim të paguajë 3.739.549,00 (tre milion e shtatëqind e tridhjetë e nëntë mijë e pesëqind e dyzet e nëntë) denarë, për kompensimin vjetor të lejes për transmetim televiziv, për periudhën nga data 28.02.2025 deri më 27.02.2026 përfundimisht deri më 01.04.2025 si afat ligjor për pagesën e kompensimit të SHTR KLAN MAQEDONI SHPKNJP eksport – import Saraj, Shkup, nga ku pagesa në shumë prej 3.739.549,00 (tre milion e shtatëqind e tridhjetë e nëntë mijë e pesëqind e dyzet e nëntë) denarë nuk është kryer.

IV. Në nenin 23 paragrafi (1) nënparagrafi 3 të LSHMAAV është përcaktuar se nëse konstatohet mosrespektim, shkelje ose cënim i dispozitave të LSHMAAV dhe akteve nënligjore, të miratura në bazë të ligjit si dhe të kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara me lejen dhe akte të tjera të Agjencisë, kundër botuesi të medias, Këshilli i Agjencisë duhet të ndërmarrë masë – heqjen e lejes.

Në pajtim me nenin 82 paragrafi (1) nënparagrafët 5 dhe 6 të LSHMAAV, Agjencia do të heqë lejen për transmetim televiziv ose radio, para skadimit të afatit për të cilën është dhënë dhe do të fshijë transmetuesin nga regjistri i transmetuesve, paraprakisht pas njoftimit të dorëzuar me shkrim, nëse pas dhënie së lejes do ndodhin situata që paraqesin pengesa Ligjore për zotëruesin e lejes për kryerjen e veprimtarisë (neni 82 paragrafi 1 nënparagrafi 5), si dhe nëse zotëruesi i lejes nuk e paguan kompensimin në afatin e përcaktua ligjor (neni 82 paragrafi 1 nënparagrafi 6).

Procedurën për heqjen e lejes për transmetim televiziv ose radio, në pajtim me nenin 83 paragrafi (1) të LSHMAAV, e inicon Këshilli me propozim të drejtorit të Agjencisë.

Duka marrë parasysh gjendjen e përcaktuar faktike të SHTR KLAN MAQEDONI SHPKNJP eksport – import Saraj, Shkup që nuk ka paguar kompensimin vjetor të lejes për

transmetim televiziv në afatin e përcaktuar ligjor – 30 ditë nga dita e pranimi të Faturës nr.2025-100-0086 datë 28.02.2025 – nr ynë.ark.05-830/1 datë 28.02.2025 (neni 80 paragrafi 5 të LSHMAAV), drejtori i Agjencisë, dr. Zoran Trajčevski në bazë të nenit 83 paragrafi (1), dhe në lidhje me nenin 82 paragrafi (1) nënparagrafi 6 të LSHMAAV, ka dorëzuar Propozimin PA1 nr.08-105 datë 03.04.2025 për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes, si shtojcë drejtua Këshillit ka dorëzuar dhe Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative (nr ynë.ark.05-1600/1 datë 02.04.2025).

Këshilli i Agjencisë në lidhje me Propozimin e lartpërmendur dhe Raportin me shkrim për mbikëqyrje të jashtëzakonshme administrative sipas detyrës zyrtare të SHTR KLAN MAQEDONI SHPKNJP eksport – import Saraj, Shkup, nr ynë.ark.03-1628/1 datë 04.04.2025, sipas të cilit transmetuesi nuk i ka plotësuar kushtet minimale kadrovike të përcaktuara në Rregulloren për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për marrjen e lejes për transmetim televiziv dhe radio (neni 62 paragrafi 6 të LSHMAAV dhe neni 21 i Rregullores së njëjtë), në seancën e 15-të mbajtur me datë 04.04.2025, në pajtim me Konkluzionin, ark.nr.02-1587/7 datë 04.04.2025, ka inicuar procedurë për heqjen e lejes për transmetim televiziv të SHTR KLAN MAQEDONI SHPKNJP eksport – import Saraj, Shkup.

Në lidhje me procedurën e inicuar për heqjen e lejes të SHTR KLAN MAQEDONI SHPKNJP eksport – import Saraj, Shkup, PA1 nr.08-128 datë 13.03.2017, dhe në pajtim me nenin 82 paragrafi (1) të LSHMAAV, Agjencia ka dërguar Njoftim (PA1 nr.08-105 datë 07.04.2025), në të cilin theksohet se nëse nuk e dorëzon dokumentacionin e nevojshëm nga ku mund të konstatohet se i plotëson kushtet minimale kadrovike të përcaktuara në Rregulloren për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për marrjen e lejes për transmetim televiziv dhe radio, si dhe nëse nuk e paguan në tërësi kompensimin vjetor të lejes për transmetim televiziv në pajtim me nenin 83 paragrafi (3) të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimi të Propozimit për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes, PA1 nr.08-105 datë 03.04.2025, do të marrë Vendim për heqjen e lejes për transmetim televiziv, nga ku në pajtim me nenin 85 paragrafi (2) të LSHMAAV, transmetuesi do të fshihet nga regjistri i transmetuesve.

Njoftimi PA1 nr.08-105 datë 07.04.2025, është dorëzuar me shkrim SHTR KLAN MAQEDONI SHPKNJP eksport – import Saraj, Shkup dhe është pranuar nga transmetuesi të njëjtën ditë. Njëkohësisht, njoftimi i datës 08.04.2025 është dorëzuar edhe në formë elektronike në adresën elektronike zyrtare të transmetuesit të regjistruar si informacion për kontakt në RRQRMV-së dhe në regjistrin e transmetuesve që udhëhiqet nga Agjencia.

Në pajtim me nenin 83 paragrafi (3) të LSHMAAV, Këshilli është i obliguar që në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të propozimit të drejtorit për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes, të marrë vendim me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit.

Agjencia, pas njoftimit të dorëzuar për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes, PA1 nr.08-105 datë 07.04.2025, dhe për të verifikuar nëse SHTR KLAN MAQEDONI SHPKNJP eksport – import Saraj, Shkup, i plotëson kushtet minimale kadrovike të përcaktuara në Rregulloren në fjalë, me datë 10.04.2025, drejtuar Agjencisë për Punësim të RMV-së dorëzoi Shkresë, ark.nr.03-395/1 datë 10.04.2025 (nr ynë.ark.03-1704/1 datë 10.04.2025), me të cilën ka kërkuar të dhëna për numrin e të punësuarve në SHTR KLAN MAQEDONI SHPKNJP eksport – import Saraj, Shkup për datën 09.04.2025 dhe për datën 10.04.2025, të pranuar nga Agjencia për Punësim e RMV-së të njëjtën ditë. Në lidhje me kërkesën e paraqitur, Agjencia për Punësim e RMV-së me Shkresë, ark.nr.03-1087/2 datë 11.04.2025, nr ynë.ark.03-1704/2 datë 11.04.2025, njoftoi Agjencinë se „sipas evidendëc së Agjencisë për Punësim të Republikës së Maqedonisë së Veriut të personave të regjistruar të papunë dhe regjistrimeve / çregjistrimeve në / nga sigurimi i detyrueshëm shoqëror, për personin juridik SHTR KLAN MAQEDONI SHPKNJP eksport – import Saraj, Shkup, numri i të punësuarve në vitin 09.04.2025 dhe në vitin 10.04.2025 është vetëm 1, ndërsa në vitin 31.03.2025 është 18“. Duke marrë parasysh njoftimin e lartpërmendur nga Agjencia për Punësim e RMV-së, më 14.04.2025 Agjencia përmes Sektorit për planifikim strategjik dhe

të drejtat e autorit, ka kryer kontroll të mbikëqyrjes administrative të punës së SHTR KLAN MAQEDONI SHPKNJP eksport – import Saraj, Shkup. Në Raportin me shkrim për kontrollin e kryer të mbikëqyrjes administrative, ark.nr.03-1734/1 datë 14.04.2025, është konstatuar se transmetuesi nuk i plotëson kushtet minimale kadrovike të përcaktuara në Rregulloren për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për dhënien e lejes për transmetim televiziv dhe radio dhe propozohet që Këshilli të marrë Vendim për heqjen e lejes për transmetim televiziv të SHTR KLAN MAQEDONI SHPKNJP eksport – import Saraj, Shkup.

Njëkohësisht, Sektori për mbështetje informatike dhe çështje të përgjithshme (SMIPP) drejtuar dr.Zoran Trajčevski, Drejtor i Agjencisë dërgoi një Shënim Zyrtar, nr ynë.ark.03-1714/1 datë 11.04.2025 se gjatë kontrollit të rregullt në sistemin për regjistrim dhe monitorim të shërbimeve televizive dhe radio me datë 10.04.2025, si dhe nga informacionet e marra, është konstatuar se SHTR KLAN MAQEDONI SHPKNJP eksport – import Saraj, Shkup nuk ka transmetuar program televiziv dhe se gjatë shqyrtimit të detajuar është konstatuar se transmetuesi ka ndërprerë transmetimin e programit televiziv me datë 08.04.2025 në orën 19:45. Me qëllim që Agjencia të veprojë në pajtim me LSHMAAV, përkatësisht për të kontrolluar nëse radiodifuzeri transmeton program televiziv, dhe në lidhje me nenin 82 paragrafi (1) nënparagrafi 2 të LSHMAAV (ndërprerja me transmetim të shërbimit programor për më shumë se 30 ditë për arsye teknike, financiare ose arsye të tjera), në shënimin zyrtar thuhet se Njësia për Mbështetjen e Informacioni dhe Teknologjisë pranë SIPOR do të vendosë nën monitorim transmetuesin në fjalë.

Prandaj, duke pasur parasysh faktin se SHTR KLAN MAQEDONI SHPKNJP eksport – import Saraj, Shkup dhe në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, nga dita e pranimit të Propozimit PA1 nr.08-105 datë 03.04.2025, nga anëtarët e Këshillit të Agjencisë, nuk e ka përmbushur detyrimin e paraparë në nenin 62 paragrafi (6) të LSHMAAV dhe neni 21 të Rregullores për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për dhënien e lejes për transmetim televiziv dhe radio, si dhe detyrimin nga neni 80 paragrafi (5) të LSHMAAV, Drejtori i Agjencisë, ka dorëzuar Propozimin PA1 nr.08-133 datë 15.04.2025 për heqjen e lejes për transmetim televiziv të transmetuesit në fjalë.

Këshilli i Agjencisë në bazë të nenit 82 paragrafi (1) nënparagrafët 5 dhe 6 dhe neni 83 paragrafi (3) të LSHMAAV, duke vepruar sipas Propozimit PA1 nr.08-133 datë 15.04.2025 dhe Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer të kontrollit administrativ, ark.nr.03-1734/1 datë 14.04.2025, dhe në pajtim me Konkluzionin e Agjencisë, ark.nr.02-1752/5 datë 16.04.2025, miratoi Vendim për heqjen e lejes PA1 nr.08-128 datë 13.03.2017 për transmetim televiziv të SHTR KLAN MAQEDONI SHPKNJP eksport – import Saraj, Shkup.

Në pajtim me nenin 24 të Rregullores për procedurat e punës financiare dhe kontabilitetit të Agjencisë, derisa zotëruesi i lejes për transmetim televiziv ose radio nuk kryen pagesën e kompensimit, sipas faturës së dorëzuar në afatin e përcaktuar në paragrafin (3) të këtij neni të Rregullores, anulohet dhe i jipet faturë e re e cila i referohet vetëm periudhës së punës, përkatësisht deri në ditën e marrjes së vendimit për heqjen e lejes, që duhet të paguhet jo më vonë se 8 (tetë) ditë nga dita e dhënies. Në të kundërtën pagesa e borxhit, do të kryhet në rrugë gjyqësore.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, Fatura 2025-100-0086 datë 28.02.2025 (nr ynë.ark.05-830/1 datë 28.02.2025) për kompensimin e lejes për transmetim televiziv, anulohet dhe SHTR KLAN MAQEDONI SHPKNJP eksport – import Saraj, Shkup, i jipet faturë e re, e cila i referohet vetëm periudhës së punës, përkatësisht deri në ditën e marrjes së vendimit për heqjen e lejes dhe që duhet të pagohet jo më vonë se 8 (tetë) ditë nga dita e dhënies.

Në pajtim me nenin 84 të LSHMAAV, Vendimi për heqjen e lejes për transmetim televiziv është përfundimtar, dhe kundër këtij vendimi zotëruesi i lejes ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit. Procedura para gjykatës kompetente është urgjente.

Bazuar në sa më sipër u mor vendim si në dispozitiv.

**Agjencia për Shërbime Mediatike  
Audio dhe Audiovizuele  
Kryetari i Këshillit,  
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi për heqjen e lejes, SHTR KLAN MAQEDONI SHPKNJP eksport – import Saraj Shkup, ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi.